

وجوب العمل بالسنة وكفر من أنكرها

**Obligueshmëria e veprimit
sipas Sunetit të Profetit ﷺ dhe
mosbesimi i atij që e refuzon
atë (Pozita e Sunetit në Islam)**

Obligueshmëria e veprimit sipas Sunetit të Profetit ﷺ dhe mosbesimi i atij që e refuzon atë (Pozita e Sunetit në Islam)

Autor:

Abdulaziz ibn Abdullah ibn Bazi (Allahu e pastë mëshiruar!)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Parathënie

Çdo lavdërim i takon Allahut, Zotit të botëve dhe fundi i lumtur është për të devotshmit. Salavati dhe selami qofshin për robin dhe të Dërguarin e Tij, Profetin tonë, Muhamedin, i cili u dërgua si mëshirë për botët, si dhe për familjen e shokët e tij, që e bartën (dhe kumtuan) Librin e Zotit të tyre të Lartësuar dhe Sunetin e Profetit të tyre ﷺ për ata që vijnë më pas, me shumë besnikëri, përsosuri dhe duke i ruajtur plotësisht kuptimet dhe shprehjet (e Kuranit dhe Sunetit). Allahu qoftë i kënaqur me ta dhe i kënaqte e na bëftë pasues të tyre në mirësi dhe argument për të gjithë njerëzit!

Dijetarët, në të kaluarën dhe sot, janë pajtuar njëzëri se bazat që merren në konsideratë për vërtetimin e vendimeve fetare dhe sqarimin e të lejuarave dhe të ndaluarave janë: Kurani i madhëruar, të cilit gënjeshtër nuk i vjen nga asnjëra anë; pastaj Suneti i të Dërguarit të Allahut ﷺ, i cili nuk fliste nga hamendja, por nga ajo që i shpallej

(prej Allahut); pastaj konsensusi i dijetarëve të umetit (ar. el ixhma). Sa u përket bazave të tjera, dijetarët kishin mendime të ndryshme rreth tyre, më e rëndësishmja prej të cilave është analogjia (ar. el kijas). Shumica e dijetarëve janë të mendimit se ajo është argument, nëse i plotëson kushtet e saj të përcaktuara. Argumentet për këto baza janë më shumë sesa të kufizohen dhe janë më të njohura sesa të përmenden.

Bazat që merren në konsideratë për vërtetimin e vendimeve fetare

Baza e parë: Kurani i madhërishëm.

Baza e parë është Kurani i madhëruar. Fjalët e Zotit tonë të Plotfuqishëm, në vende të ndryshme të Librit të Tij, tregojnë se është e domosdoshme ndjekja e këtij Libri, kapja fort për të dhe qëndrimi te kufijtë e tij.

Allahu i Madhërishëm thotë:

﴿وَهَذَا كِتَابٌ أَنْزَلْنَاهُ مَبَارَكٌ فَاتَّبِعُوهُ وَاتَّقُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾

"Ky Libër që kemi shpallur është i bekuar, prandaj ndiqeni dhe druajuni kundërshtimit, në mënyrë që të mëshiroheni." (Kurani, 6:155)

Allahu i Madhëruar thotë gjithashtu:

﴿قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ
قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ
وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ﴾

“Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kurani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësirat në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.” (Kurani, 5:15-16)

Allahu i Madhëruar, po ashtu, thotë:

﴿إِنَّ الَّذِينَ كَفَرُوا بِالذِّكْرِ لَمَّا جَاءَهُمْ وَإِنَّهُ لَكِتَابٌ عَزِيزٌ لَا يَأْتِيهِ الْبَاطِلُ مِنْ بَيْنِ يَدَيْهِ وَلَا مِنْ خَلْفِهِ تَنْزِيلٌ مِنْ حَكِيمٍ حَمِيدٍ﴾

“Ata që e mohojnë Fjalën Tonë përkujtuese (Kuranin), kur u vjen, do të dënohen rëndë. Ai është vërtet një Libër i madhërishëm. Atij nuk mund t’i afrohet gënjeshtria nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.” (Kurani, 41: 41-42)

Gjithashtu thotë:

﴿وَأُوحِيَ إِلَيَّ هَذَا الْقُرْآنُ لِأُنذِرَكُمْ بِهِ وَمَنْ بَلَغَ﴾

“Ky Kuran më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t’jua tërheq vërejtjen juve dhe kujtdo që i përcillet.” (Kurani, 6:19)

Po ashtu thotë:

﴿هَذَا بَلَاغٌ لِلنَّاسِ وَلِيُنذَرُوا بِهِ﴾

Ky (Kuran) është shpallje e qartë për njerëzit, me qëllim që ata të marrin paralajmërim nëpërmjet tij...” (Kurani, 14:52)

Ajetet që bartin këtë kuptim janë të shumta. Hadithet e vërteta që përcillen nga i Dërguari i Allahut ﷺ, të cilat urdhërojnë të kapemi fort për

Kuran, tregojnë se kushdo që i përmbahet atij është në udhëzim, e kush e lë atë është në devijim. Ndër hadithet që bartin këtë kuptim është hadithi që është vërtetuar nga Profeti ﷺ, i cili në hutben e tij gjatë Haxhillëkut Lamtumurës, ka thënë:

(إِنِّي تَارِكٌ فِيكُمْ مَا لَنْ تَضْلُوا إِنْ اعْتَصَمْتُمْ بِهِ كِتَابَ اللَّهِ)

“Unë po e lë mes jush atë që nuk do të humbisni, nëse mbaheni fort pas tij: Librin e Allahut (Kuranin).”

E shënon Muslimi në "Sahihun" e tij.

Gjithashtu në "Sahihun" e Muslimit shënohet se Zejd ibn Erkami (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se Profeti ﷺ ka thënë:

« إِنِّي تَارِكٌ فِيكُمْ ثَقَلَيْنِ أَوَّلُهُمَا كِتَابُ اللَّهِ فِيهِ الْهُدَى وَالنُّورُ فَخُذُوا بِكِتَابِ اللَّهِ وَتَمَسَّكُوا بِهِ »

“Po jua lë dy gjëra të çmueshme: e para është Libri i Allahut, përkatësisht Litari i Allahut: ai që e pason atë, do të jetë në udhëzim, kurse ai që e braktis, do të jetë në devijim.”¹

Inkurajoi dhe motivoi që të kapemi fort për Librin e Allahut, pastaj tha:

«وَأَهْلُ بَيْتِي أَذْكُرُكُمْ اللَّهُ فِي أَهْلِ بَيْتِي أَذْكُرُكُمْ اللَّهُ فِي أَهْلِ بَيْتِي»

“Familja ime! Jua kujtoj Allahun të silleni mirë me familjen time! Jua kujtoj Allahun që të silleni mirë me familjen time.”

¹ Me këtë tekst e shënon Muslimi. Shënim i përkthyesit.

Në një transmetim përcillet se ka thënë për Kuranin:

هو حبل الله من تمسك به كان على الهدى ومن تركه كان على الضلال.

“(Kurani) është Litari i Allahut; kush kapet për të, do të jetë në udhëzim, kurse ai që e braktis, do të jetë në devijim.”

Hadithet që bartin këtë kuptim janë të shumta. Konsensusi (ar. el ixhma) i njerëzve të dijes dhe të besimit, nga sahabët dhe ata pas tyre, që tregon për domosdoshmërinë e kapjes fort për Librin e Allahut, gjykimin me të dhe të gjykuarit tek ai, së bashku me Sunetin e të Dërguarit të Allahut ﷺ, mjafton dhe nuk ka nevojë që të zgjatemi më shumë për të përmendur argumente përkitazi me këtë çështje.

Baza e dytë: ajo që është saktësuar nga Dërguari i Allahut ﷺ, sahabët dhe ata pas tyre, nga njerëzit e dijes dhe të besimit.

Sa i përket bazës së dytë, nga tri bazat të cilat janë konsensuale, është ajo që është saktësuar nga Dërguari i Allahut ﷺ, sahabët dhe ata pas tyre, nga njerëzit e dijes dhe besimit. Ata besojnë në këtë bazë themelore me të cilën argumentojnë dhe të cilën ia mësojnë umetit (popullit musliman). Ata shkruan shumë libra për këtë dhe e shpjeguan në librat e bazave të jurisprudencës (ar. usul el fikh) dhe në terminologjinë (e hadithit). Argumentet për këtë janë me bollëk, saqë janë të panumërta. Ndër

to është ajo që ka ardhur në Librin e madhëruar të Allahut në lidhje me urdhrin për ta ndjekur dhe për t’iu bindur Profetit ﷺ; ky urdhër u drejtohet njerëzve të kohës së tij dhe atyre që vijnë pas tyre, sepse ai është i Dërguari i Allahut për të gjithë dhe për shkak se ata janë të urdhëruar që ta pasojnë dhe t’i binden derisa të vijë Kiameti, dhe se Profeti ﷺ është shpjguesi i Librit të Allahut dhe sqaruesi i asaj që është përmendur në të në mënyrë të përmbledhur; ku këtë e shpjegon me fjalët, veprat dhe miratimet e tij. Sikur të mos ishte Suneti, muslimanët nuk do ta dinin numrin e rekateve të namazeve, formën e tyre dhe çfarë është obligim në to. Nuk do t’i dinin në mënyrë të hollësishme dispozitat e agjërimit, zekatit, haxhillëkut, xhihadit, urdhërimit për të mirë dhe ndalimit të së keqes. Nuk do t’i dinin në mënyrë të hollësishme dispozitat mbi transaksionet e ndalesat dhe dënimet e paracaktuara fetarisht (ar. hudud) dhe ndëshkimet, që Allahu i ka bërë obligim në lidhje me mëkate të caktuara, të cilat janë përmendur në Kuran (në mënyrë të përgjithshme). Prej ajeteve përkitazi me këtë çështje është fjala e Allahut të Lartësuar në suren Ali Imran:

﴿وَأَطِيعُوا اللَّهَ وَالرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën (e Allahut).” (Kurani, 3:132)

Dhe fjala e Allahut në suren en Nisa:

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا﴾

“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja nga mesi juaj (muslimanët). Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.” (Kurani, 4:59)¹

Po ashtu Allahu në suren en Nisa thotë:

﴿مَنْ يُطِيعِ الرَّسُولَ فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ وَمَنْ تَوَلَّىٰ فَمَا أَرْسَلْنَاكَ عَلَيْهِمْ حَفِيظًا﴾

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut. Sa për ata që kthejnë kokën mënjanë, Ne nuk të kemi dërguar që të jesh rojtar i tyre.” (Kurani, 4:80)

Si është e mundur vallë t’i bindemi atij dhe të referohen njerëzit te Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij për gjërat që janë në kundërshti, nëse nuk argumentohet me Sunetin i tij ose nëse ai nuk është i ruajtur në tërësi?! Sipas këtij mendimi, i bie që Allahu i ka urdhëruar robërit e Tij për diçka që nuk ekziston, gjë që është prej gënjeshtërs dhe prej kufrit (mosbesimit) më të madh në Allahun dhe prej mendimit të keq për Të.

¹ Drejtimi tek Allahu i Lartësuar bëhet kur të kthehemi te Kurani, ndërsa drejtimi tek i Dërguari ﷺ teksa ishte gjallë bëhej duke shkuar tek ai, e tani, pas vdekejs së tij, bëhet duke u kthyer te Suneti, respektivisht tradita e udhëzimi i tij. (Shënim i përkthyesit).

Allahu i Lartmadhëruar në suren en Nahl thotë:

﴿وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ﴾

“Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë.” (Kurani, 16:44)

Po ashtu në po të njëjtën sure thotë:

﴿وَمَا أَنْزَلْنَا عَلَيْكَ الْكِتَابَ إِلَّا لِتُبَيِّنَ لَهُمُ الَّذِي اخْتَلَفُوا فِيهِ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ﴾

“Ne ta kemi zbritur ty Librin, vetëm që ti t’u sqarosh atyre çështjet, për të cilat ata nuk pajtoheshin, si dhe që të jetë udhërrëfyes e mëshirë për njerëzit që besojnë.” (Kurani, 16:64)

Vallë, si mundet që Allahu t’ia lërë të Dërguarit të Tij ﷺ shpjegimin e Kuranit që u zbriti atyre, nëse Suneti nuk do të ekzistonte e nuk do të kishte forcë argumentuese?!

Ngjashëm me këtë është fjala e Allahut të Lartësuar në suren en Nur:

﴿قُلْ أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ فَإِنْ تَوَلَّوْا فَإِنَّمَا عَلَيْهِ مَا حُمِّلَ وَعَلَيْكُمْ مَا حُمِّلْتُمْ وَإِنْ تُطِيعُوهُ تَهْتَدُوا وَمَا عَلَى الرَّسُولِ إِلَّا الْبَلَاغُ الْمُبِينُ﴾

“Thuaj: “Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit!” Nëse shmangeni, (ta dini se) ai (Profeti Muhamed) është përgjegjës për detyrën e tij, ndërsa ju për atë që jeni ngarkuar. E, nëse i bindeni atij, do të jeni në rrugën e drejtë, kurse i Dërguari është i detyruar vetëm që të përcjellë qartë (Mesazhin Hyjnor).” (Kurani, 24: 54)

Në po të njëjtën sure, Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ﴾

“Falni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!”
(Kurani, 24:56)

Allahu i Lartësuar thotë në suren el Araf:

﴿قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ
لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ فَأَمَّا أُولَئِكَ الَّذِينَ كَفَرُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ النَّبِيِّ الْأُمِّيِّ الَّذِي يُؤْمِنُ بِاللَّهِ
وَكَلِمَاتِهِ وَاتَّبَعُوهُ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ﴾

“Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas tij, që të jeni në rrugën e drejtë!” (Kurani, 7:158)

Këto ajete janë argument i qartë se udhëzimi dhe mëshira arrihet duke e pasuar Profetin ﷺ. Vallë, si mund të udhëzohemi e të mëshirohemi, nëse nuk punojmë me Sunetin e tij, ose të thuhet se Suneti nuk është i vërtetë ose nuk duhet të bazohemi tek ai.

Allahu i Lartmadhëruar në suren en Nur thotë:

﴿فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ﴾

“Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm.” (Kurani, 24:63)

Në suren el Hashr, thotë:

﴿وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا﴾

“Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj.” (Kurani, 59:7)

Ajete që bartin këtë kuptim janë të shumta; të gjitha tregojnë se është obligim të pasohet Profeti ﷺ dhe të ndiqet ajo me të cilën ai erdhi, ashtu siç paraprinë argumentet, të cilat tregojnë se është obligim ndjekja e Librit të Allahut dhe kapja fort për të dhe nënshtrimi ndaj urdhrave dhe ndalesave të tij. Këto janë dy baza të pandashme mes njëra-tjetrës; kushdo që e mohon njërin, e ka mohuar dhe përgënjeshtruar tjetrën, gjë që është kufër (mosbesim), devijim dhe dalje nga rrethi i Islamit, sipas konsensusit të ithtarëve të dijes dhe të besimit.

Prej haditheve që përcillen, të cilat tregojnë se duhet ta ndjekim Sunetin e të Dërguarit të Allahut ﷺ:

Ekzistojnë hadithe mutevatira (të shkallës më të lartë të vërtetësisë) nga i Dërguari i Allahut ﷺ, të cilat tregojnë se është obligim t’i bindemi dhe ta ndjekim Profetin ﷺ në gjërat me të cilat ka ardhur dhe është e ndaluar ta kundërshtojmë. Kjo i përfshin ata që ishin në kohën e tij dhe për ata që do të vijnë pas tij deri në Ditën e Kiametit. Prej këtyre haditheve e theksojmë hadithin që shënohet

në dy koleksionet e haditheve të vërteta, të Buhariut dhe të Muslimit, nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se Profeti ﷺ ka thënë:¹

«مَنْ أَطَاعَنِي فَقَدْ أَطَاعَ اللَّهَ وَمَنْ عَصَانِي فَقَدْ عَصَى اللَّهَ»

“Ai që më bindet mua, i është bindur Allahut, e ai që më kundërvihet mua, i është kundërvënë Allahut.”

Në koleksionin e haditheve të vërteta të Buhariut shënohet se Profeti ﷺ ka thënë:

«كُلُّ أُمَّتِي يَدْخُلُونَ الْجَنَّةَ إِلَّا مَنْ أَبَى قِيلَ يَا رَسُولَ اللَّهِ وَمَنْ يَأْبَى قَالَ مَنْ أَطَاعَنِي دَخَلَ الْجَنَّةَ وَمَنْ عَصَانِي فَقَدْ أَبَى»

“Gjithë umeti im do të hyjnë në Xhenet, përveç atyre që refuzojnë.”

- O i Dërguari i Allahut, e kush refuzon? - pyetën të pranishmit.

- “Kush më bindet mua, do të hyjë në Xhenet, e, kush më kundërshton, ka refuzuar”, - tha Profeti ﷺ.

Ahmedi, Ebu Davdi dhe Hakimi e shënojnë me zinxhir të saktë të transmetuesve, nga Mikdam ibn Madikeribi, se Profeti ﷺ ka thënë:

«أَلَا إِنِّي أُوتِيتُ الْكِتَابَ وَمِثْلَهُ مَعَهُ أَلَا يُوشِكُ رَجُلٌ شَبَعَانُ عَلَى أُرَيْكَتِهِ يَقُولُ عَلَيْكُمْ بِهَذَا الْقُرْآنِ فَمَا وَجَدْتُمْ فِيهِ مِنْ حَلَالٍ فَأَجْلَوْهُ وَمَا وَجَدْتُمْ فِيهِ مِنْ حَرَامٍ فَحَرَّمُوهُ»

“Vini re! Mua më është dhënë Libri (Kurani) dhe një i ngjashëm me të (Suneti). Vini re! Shumë shpejt

¹ Hadithi mutevatir është ai hadith që e transmetojnë një grup i madh njerëzish që nga fillimi i zinxhirit të transmetuesve (senedit) deri në fund. Ky numër i madh transmetuesish e bën të pamundur që ata të bien në ujdj për të gënjer, si dhe baza e lajmit të tyre janë shqisat. Pra, thonë: “Kemi dëgjuar”, ose “kemi parë”. (Shënim i përkthyesit).

do të vijë koha kur një njeri i ngopur, i ulur në kolltukun e tij, do të thotë: “Kapuni fort për këtë Kuran! Atë që e gjeni të lejuar në të, trajtojeni si të lejuar, si dhe atë që gjeni në të si të ndaluar, trajtojeni si të ndaluar!”

Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe e shënojnë me zinxhir të saktë të transmetuesve, nga Ibn Ebu Rafiu, nga babi i tij, se Profeti ﷺ ka thënë:

«لَا أَفْقِينَ أَحَدَكُمْ مُتَكِنًا عَلَى أَرِيكَتِهِ يَأْتِيهِ الْأَمْرُ مِنْ أَمْرِي مِمَّا أَمَرْتُ بِهِ أَوْ نَهَيْتُ عَنْهُ فَيَقُولُ لَا نَذْرِي، مَا وَجَدْنَا فِي كِتَابِ اللَّهِ اتَّبَعْنَاهُ»

"Assesi të mos gjej ndokënd prej jush të mbështetur në kolltuk që, kur t'i vijë ndonjë urdhër imi që kam urdhëruar për të ose që kam ndaluar, e të thotë: "Nuk e dimë! Atë që e gjejmë në Kuran e pasojmë."

Hasen ibn Xhabiri tregon se e ka dëgjuar Mikdam ibn Madikeribin (Allahu qoftë i kënaqur me të!) duke thënë:

حَرَّمَ رَسُولُ اللَّهِ -صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ- يَوْمَ خَيْبَرَ أَشْيَاءَ ثُمَّ قَالَ «يُوشِكُ أَحَدُكُمْ أَنْ يُكَذِّبَنِي وَهُوَ مُتَكِنٌ يُحَدِّثُ بِحَدِيثِي فَيَقُولُ بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمْ كِتَابُ اللَّهِ فَمَا وَجَدْنَا فِيهِ مِنْ حَلَالٍ اسْتَخْلَلْنَاهُ وَمَا وَجَدْنَا فِيهِ مِنْ حَرَامٍ حَرَّمْنَاهُ إِلَّا إِنَّ مَا حَرَّمَ رَسُولُ اللَّهِ مِنْهُلَّ مَا حَرَّمَ اللَّهُ»

"Kam frikë që dikush të më përgënjeshtrojë: duke qenë ulur flet me ndonjë hadith timin e thotë: "Mes nesh dhe jush është Libri i Allahut (Kurani): atë që e gjejmë në të të lejuar, e konsiderojmë të tillë dhe atë që e gjejmë të ndaluar, e konsiderojmë të tillë."

Vini re! Atë që e konsideron të ndaluar i Dërguari i Allahut është sikurse ta ketë ndaluar Allahu.”

E shënojnë Hakimi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe me zinxhir të saktë të transmetuesve.

Ekzistojnë hadithe mutevatira (të shkallës më të lartë të vërtetësisë) nga i Dërguari i Allahut ﷺ se ai i këshillonte sahabët në hutben e tij, që ata që ishin të pranishëm t’ua përcillnin atyre që mungojnë, e u thoshte:

«رَبِّ مَبْلَغٍ أَوْ عَى مِنْ سَامِعٍ»

“...sepse atij që do t’i kumtohet, ndoshta e kupton më mirë se këta që po e dëgjojnë.”

Në këtë kontekst është hadithi që shënohet në dy koleksionet e haditheve të vërteta, të Buhariut dhe Muslimit, ku Profeti ﷺ u ligjëroi njerëzve në Haxhillëkun e Lamtumirës, në ditën e Arafatit, përkatësisht në ditën e Bajramit të Kurbanit, kur u tha:

«فَلْيَبْلَغِ الشَّاهِدُ الْغَائِبَ فَرَبِّ مَبْلَغٍ أَوْ عَى مِنْ سَامِعٍ»

“Të pranishmit le t’ua përcjellin atyre që mungojnë.”

Sikur të mos kishte Suneti i Profetit ﷺ forcë argumentuese për atë që e dëgjon e ishte i pranishëm dhe për atë të cilit i përcillet dhe sikur të mos ishte i përhershëm deri në Ditën e Kiametit, atëherë nuk do t’i urdhëronte ta kumtonin atë te të tjerët. Kësisoj u kuptua se Suneti ka forcë argumentuese për atë që e dëgjoji nga vetë goja e

Profetit ﷺ dhe për atë të cilit iu kumtua përmes zinxhirëve të saktë të transmetuesve.

Sahabët e të Dërguarit të Allahut ﷺ e ruajtën Sunetin e Profetit ﷺ: gojor dhe vepror, si dhe ua përcollën atyre që erdhën pas tyre, pra, tabiinëve, e më pas këta ua përcollën atyre që erdhën pas tyre. Kështu e përcollën dijetarët e besueshëm brez pas brezi dhe gjeneratë pas gjenerate; i tubuan në librat e tyre dhe i sqaruan hadithet e vërteta nga ato të pavërtetat. Për ta njohur këtë gjë, ata vendosën ligje dhe rregulla të njohura, me të cilat njihet Suneti i vërtetë nga ai i pavërtetë. Dijetarët i kanë përhapur librat e Sunetit, si dy koleksionet e haditheve të vërteta; të Buhariut dhe Muslimit si dhe të tjera, ku i mësuan përmendsh plotësisht, ashtu siç e ruajti Allahu Librin e Tij të Madhëruar nga mendjelehtësia e mendjelehtëve, shtrembërimi i shtrembëruesve dhe deformimi i deformuesve, për ta jetësuar kështu fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿إِنَّا نَحْنُ نَزَّلْنَا الذِّكْرَ وَإِنَّا لَهُ لَحَافِظُونَ﴾

"Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kuranin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë." (Kurani, 15:9)

Nuk ka dyshim se Suneti i të Dërguarit të Allahut ﷺ është shpallje hyjnore e zbritur (nga Allahu). Allahu i Lartësuar e ruajti Sunetin ashtu siç e ruajti Librin e Tij (Kuranin) dhe Ai caktoi dijetarët verifikues e kritikë, të cilët e mbrojnë Sunetin nga shtrembërimi i mohuesve dhe interpretimi i

inJORantëve, si dhe e pastrojnë nga çdo gjë që ia kanë veshur inJORantët, gënjeshtarët dhe ateistët, sepse Allahu i Madhëruar e bëri Sunetin shpjegues të Librit të Tij të Madhëruar dhe sqarim të vendimeve që janë përmendur të përmbledhura në Kuran, si dhe ka përfshirë vendimet e tjera që nuk janë në Kuranin e madhëruar, fjala vjen, shpjegimi i detajuar i dispozitave të gjidhënies, disa dispozitave të trashëgimisë, ndalimi i bashkimit në një martesë ndërmjet gruas dhe hallës së saj dhe midis gruas e tezes së saj, si dhe dispozitave e vendimeve të tjera me të cilat erdhi Suneti i saktë dhe nuk janë përmendur në Kuranin e madhëruar. Po përmend disa raste se si e madhëruan dhe respektuan Sunetin dhe punuan me të sahabët, tabiinët dhe ata që erdhën pas tyre, nga dijetarët.

Në dy koleksionet e haditheve të vërteta, të Buhariut dhe Muslimit, përcillet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se ka thënë:

لما توفي رسول الله -صلى الله عليه وسلم- وارتد من ارتد من العرب قال أبو بكر الصديق -رضي الله عنه- والله لأقاتلن من فرق بين الصلاة والزكاة، فقال له عمر -رضي الله عنه-: «كيف تقاتلهم وقد قال النبي -صلى الله عليه وسلم-: «أَمُرْتُ أَنْ أَقَاتِلَ النَّاسَ حَتَّى يَقُولُوا لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ فَإِذَا قَالُوا عَصَمُوا مِنِّي دِمَاءَهُمْ وَأَمْوَالَهُمْ إِلَّا بِحَقِّهَا» فقال أبو بكر الصديق: أليست الزكاة من حقها والله لو منعوني عناقاً كانوا يؤدونها إلى رسول الله -صلى الله عليه وسلم- لقاتلتهم على منعها. فقال عمر -رضي الله عنه-: فما هو إلا أن عرفت أن الله قد شرح صدر أبي بكر للقتال فعرفت أنه الحق،

"Pasi vdiq i Dërguari i Allahut ﷺ, shumë arabë u bënë renegatë. Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur

me të!) tha: "Betohem në Allahun se do t'i luftoj ata që bëjnë dallim mes namazit dhe zekatit." Omeri i tha Ebu Bekrit: "Si po i lufton njerëzit, ndërkohë Profeti ﷺ ka thënë: "Jam urdhëruar t'i luftoj njerëzit derisa të thonë: "La ilahe il-lallah." Kur ta thonë atë, prej meje e kanë të siguruar jetën dhe pasurinë, përveç (nëse bie ndesh) me të drejtën (islame)." Atëherë Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tha: "A nuk është zekati prej të drejtës së saj?! Betohem në Allahun se, nëse nuk më japin qoftë dhe një qengj, të cilin ia jepnin të Dërguarit të Allahut ﷺ, do t'i luftoj për shkak të mosdhënies." Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tha: "Kështu, e kuptova se Allahu ia kishte hapur zemrën Ebu Bekrit (duke e udhëzuar) për luftë, andaj u binda se kjo është e vërteta."

Në dy koleksionet e haditheve të vërteta, të Buhariut dhe Muslimit, përcillet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë:

"Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) e ndoqën Ebu Bekrin (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në këtë vendim, kështu që i luftuan renegatët (murtedët) derisa i kthyen në Islam dhe i vranë ata që insistuan për të vazhduar në dezertim (dalje prej fesë). Kjo ngjarje është argumenti më i qartë që tregon se si e madhëruan dhe respektuan Sunetin e punuan me të, duke e konsideruar këtë gjë obligim. Një plakë shkoi tek Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) për ta pyetur për të drejtën e saj

trashëgimore, e në atë rast i tha: "Në Librin e Allahut nuk është caktuar gjë (për trashëgimi për ty) e as di gjë nga i Dërguari i Allahut ﷺ të ketë caktuar për ty diçka, por do t'i pyes edhe njerëzit."

Pastaj Ebu Bekri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i pyeti sahabët dhe disa prej tyre dëshmuan në prani të tij se Profeti ﷺ caktoi një të gjashtën për plakën dhe ai kështu veproi. Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i këshillonte punëtorët e tij që të gjykonin mes njerëzve sipas Librit të Allahut; nëse nuk e gjejnë atë çështje në Librin e Allahut, atëherë të gjykojnë sipas Sunetit të të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Kur Omer ibn Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i bëri problem çështja e gruas që aborton foshnjën të vdekur si pasojë e goditjes nga tjetërkush, i pyeti sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) për këtë gjë. Të pranishëm qenë Muhamed ibn Mesleme dhe Mugire ibn Shuëbe (Allahu qoftë i kënaqur me të dytë!) dhe thanë se Profeti ﷺ gjykoi që shpagimi për të të jetë sa vlera e robit ose robëreshës së shtrenjtë, kështu që Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) gjykoi në këtë mënyrë.

Kur Othmanit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i bëri problem vendimi për periudhën e pritjes së gruas (ar. idetit) në shtëpinë e saj pas vdekjes së burrit, atëherë Furejah bint Malik ibn Sinani, motra e Ebu Seidit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i tregoi se Profeti ﷺ e ka urdhëruar atë që pas vdekjes së

burrit të saj të qëndrojë në shtëpinë e tij derisa t'i mbarojë periudha e pritjes (katër muaj e dhjetë ditë), rrjedhimisht ai gjykoi në këtë mënyrë.

Kështu, Othmani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) gjykoi sipas Sunetit sa i përket dënimit të paracaktuar fetarisht për pirjen e alkoolit (ar. hadd) nga ana e Velid ibn Ukbës (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Kur i arriti Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të!) lajmi se Othmani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e ndaloi të kryhet lloji i haxhillëkut temetu, atëherë Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) hyri në ihram për haxhillëk dhe umre (haxhillëk kiran) dhe tha:¹ "Nuk e lë Sunetin e të Dërguait të Allahut ﷺ për fjalën e askujt." Kur disa njerëz u argumentuan kundër Ibn Abasit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), - rreth llojit të haxhillëkut temetu, - me fjalën e Ebu Bekrit dhe të Omerit (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) për favorizimin e haxhillëkut ifrad, atëherë Ibn Abasi u tha: "Gati kanë për t'ju rënë gurë prej Qiellit! Unë ju them: "I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë..., e ju më thoni se ka thënë Ebu Bekri dhe Omeri." Nëse frikësohemi nga dënimi për atë që e kundërshton Sunetin për fjalët e Ebu Bekrit

¹ "Othmani (Allahu qoftë i kënaqur me të!) mendonte se kryerja e llojit të haxhit temetu ishte e veçantë për atë vit në të cilin e bëri Profeti ﷺ haxhillëkun." Po ashtu ndalonte edhe llojin e haxhillëkut kiran. Me ndalesë kishte për qëllim se dëshironte të kryente haxhillëkun ifrad. E, kur e pa Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) këtë ndalesë të këtyre dy llojeve të haxhillëkut, atij temetu dhe kiran, atëherë hyri në ihram për haxhillëk dhe umre (haxhillëk kiran). Shënim i përkthyesit.

dhe Omerit, atëherë si thua për atë që e kundërshton atë për fjalën e dikujt që është nën ta, ose thjesht për mendimin dhe ixhtihadin e tij (përpjekjen individuale)?! Kur disa njerëz nuk u pajtuan me Abdullah ibn Omerin (Allahu qoftë i kënaqur me të!) rreth disa suneteve, atëherë ai u tha: "Ne jemi të urdhëruar ta ndjekim Omerin apo ta ndjekim Sunetin?"

Teksa po u fliste Imran ibn Husajni (Allahu qoftë i kënaqur me të!) rreth Sunetit, atëherë një njeri i tha: "Na fol rreth Kuranit!" Kështu, ai u zemërua (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe tha: "Suneti është shpjegim i Librit të Allahut. Po të mos kishte qenë Suneti, ne nuk do ta dinim se dreka është katër (rekate), akshami është tre, e sabahu është dy. As do t'i dinim vendimet e zekatit hollësisht e as vendimet e tjera, të cilat i ka shpjeguar hollësisht Suneti." Etheret (transmetimet e gjurmët) e sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) në lidhje me madhërimin e Sunetit dhe obligueshmërinë e të vepruarit sipas tij, si dhe tërheqja e vërejtjes kundër kundërshtimit të tij janë të shumta. Prej këtyre theksojmë se, kur Abdullah ibn Omeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e tregoi hadithin e Profetit ﷺ:

﴿لَا تَمْنَعُوا إِمَاءَ اللَّهِ مَسَاجِدَ اللَّهِ﴾

"Mos i ndalni robëreshat e Allahut prej xhamive të Allahut!"

Njëri prej bijve të tij tha: "Pasha Allahun, gjithsesi kemi për t'i ndalur!" Atëherë Abdullahu u hidhërua me të, e qortoi shumë dhe e i tha: "Po të them se ka thënë i Dërguari i Allahut, ndërsa ti po thua: "Pasha Allahun, gjithsesi do t'i ndalim." Kur Abdullah ibn Mugafel Muzeniu (Allahu qoftë i kënaqur me të!), - i cili ishte një nga shokët e të Dërguarit të Allahut ﷺ, - pa njërin nga të afërmit e tij duke gjuajtur me guralecë, e ndaloi nga ky veprim dhe i tha: "Profeti ﷺ ka ndaluar gjuajtjen me guralecë, sepse me të as gjahtohet gjahu, as mbytet armiku, por vetëm mund t'ia thyesh ndokujt dhëmbin ose t'ia qorros shyrin." Pas një kohe e pa përsëri duke gjuajtur me guralecë dhe i tha: "Pasha Allahun, nuk do të të flas kurrë. Unë po të tregoj se i Dërguari i Allahut ﷺ e ka ndaluar gjuajtjen me guralecë, kurse ti po vazhdon të gjuash?!"

E shënon Bejhekiu nga tabiini i nderuar, Ejub Sihtijaniu, se ka thënë: "Kur t'i flasësh një njeriu me Sunet (hadithe) e të të thotë: "Lëre këtë e na trego nga Kurani!", dije se ai është i humbur." Euzaiu (Allahu e pastë mëshiruar!) ka thënë: "Suneti e sqaron Kuranin, e kufizon të pakufizuarën ose sjell dispozita që nuk janë përmendur në Kuran, ashtu siç qëndron në fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿وَأَنزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ﴾

"Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve atë

që u është shpallur dhe që ata të mendojnë.”
(Kurani, 16:44)

Më lart e përmendëm hadithin e Profetit ﷺ:

«أَلَا إِنِّي أُوتِيتُ الْكِتَابَ وَمِثْلَهُ مَعَهُ»

“Vini re! Mua më është dhënë Libri (Kurani) dhe një i ngjashëm me të (Suneti).”

E shënon Bejhekiu nga Amir Shabiu (Allahu e pastë mëshiruar!), se ai u tha disa njerëzve: "Ju u shkatërruat kur i braktisët etheret, respektivisht hadithet e vërteta."

Gjithashtu e shënon Bejhekiu nga Euzaiu (Allahu e pastë mëshiruar!), se ky i fundit i paskësh thënë një shokut të vet: "Kur të të vijë nga i Dërguari i Allahut ﷺ ndonjë hadith, kujdes mos e braktis e të veprosh me diçka tjetër, sepse i Dërguari i Allahut është kumtues nga Allahu i Lartësuar."

E shënon Bejhekiu nga imami i nderuar, Sufjan ibn Seid Theuriu (Allahu e pastë mëshiruar!), se ka thënë: "E tërë dija është dija e ethereve (haditheve)." Maliku (Allahu e pastë mëshiruar!) ka thënë: "Secilit prej nesh i merret dhe i lihet fjala, përveç këtij që është në këtë varr." Ai bëri me shenjë drejt varrit të të Dërguarit të Allahut ﷺ.

Ebu Hanifja (Allahu e pastë mëshiruar!) ka thënë: "Kur të vijë hadithi nga i Dërguari i Allahut ﷺ, e pranojmë të nënshtuar."

Shafiu (Allahu e pastë mëshiruar!) ka thënë: "Atëherë kur t'ju përcjell një hadith të vërtetë nga i

Dërguari i Allahut ﷺ dhe nuk punoj me të, dijeni se më kanë lënë mendtë."

Po ashtu ka thënë (Allahu e pastë mëshiruar!): "Nëse them një mendim, ndërkohë hadithi i të Dërguarit të Allahut ﷺ e thotë të kundërtën, atëherë mendimin tim hidheni për muri."

Imam Ahmedi (Allahu e pastë mëshiruar!) i ka thënë një shokut të vet: "Mos më ndiq mua, as Malikun e Shafiun, por merr andej nga kemi marrë edhe ne (nga hadithet)."

Gjithashtu ka thënë (Allahu e pastë mëshiruar!): "Çuditë me ata njerëz të cilët e njohën saktësinë e isnadit (zinxhirin e transmetuesve) nga i Dërguari i Allahut ﷺ dhe e marrin mendimin e Sufjanit, e Allahu i Lartësuar thotë:

﴿فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ﴾

"Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm." (Kurani, 24:63) Ai tha: "A e di ç'është sprovë? Sprovë (fitneja) është për qëllim idhujtaria (shirku). Ndodh që, kur ta refuzojë ndonjë hadith të Profetit ﷺ, në zemrën e tij të futet devijimi, e kështu të shkatërrohet."

E shënon Bejhekiu nga tabiini i nderuar, Muxhahid ibn Xhebri (Allahu e pastë mëshiruar!), se për fjalën e Allahut të Lartësuar:

﴿فَإِنْ تَنَزَّاعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ﴾

"Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit..." (Kurani, 4:59) Është shprehur: "Të drejtohem tek Allahu, nënkupton te Kurani, si dhe të drejtohem te Profeti, nënkupton te Suneti (udhëzimi i tij)."

E shënon Bejhekiu nga Zuhriu (Allahu e pastë mëshiruar!) se ka thënë: "Dijetarët tanë në të kaluarën thoshin: "Kapja për Sunetin është shpëtim." Muvefekudin ibn Kudame (Allahu e pastë mëshiruar!), në librin e tij: "Raudatu en nadhir", teksa flet rreth: "Sqarimit të bazave të vendimeve", shprehet: "Baza e dytë e argumenteve është Suneti i të Dërguarit të Allahut ﷺ. Fjala e të Dërguarit të Allahut ﷺ është argument, sepse mrekullia tregon se ai ishte i sinqertë. Allahu urdhëroi t'i bindemi atij dhe na tërhoqi vërejtjen që të mos e kundërshtojmë urdhrin e tij."

Mbaroi qëllimi i fjalës së tij.

Hafidh ibn Kethiri (Allahu e pastë mëshiruar!), për komentimin e fjalës së Allahut të Lartësuar:

﴿فَلْيَحْذَرِ الَّذِينَ يُخَالِفُونَ عَنْ أَمْرِهِ أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ﴾

"Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm", (Kurani, 24:63) ka thënë: "Domethënë, të mos e kundërshtojnë urdhrin e të Dërguarit të Allahut ﷺ. Urdhri i tij është rruga, metoda e tij, Suneti dhe sheriat i tij, kështu që fjalët dhe veprat peshohen me fjalët dhe veprat

e Profetit ﷺ. Ajo që është në përputhje me të, pranohet, e ajo që nuk është në përputhje, i refuzohet atij që e ka thënë ose e ka vepruar, kushdo qoftë ai."

Shënohet në dy koleksionet e haditheve të vërteta, të Buhariut dhe Muslimit, se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:

«مَنْ عَمِلَ عَمَلًا لَيْسَ عَلَيْهِ أَمْرُنَا فَهُوَ رَدٌّ»

"Atij që bën ndonjë vepër që nuk është në përputhje me çështjen (fenë) tonë, i refuzohet."

Pra, të frikësohet dhe të bëjë kujdes ai që e kundërshton shariatën e Profetit ﷺ, qoftë në anën e tij të brendshme, qoftë në atë të jashtme:

﴿أَنْ تُصِيبَهُمْ فِتْنَةٌ﴾

"... që të mos i arrijë ndonjë sprovë..."

Pra, në zemrat e tyre, qoftë kufër (mosbesim), qoftë nifak (hipokrizi), qoftë bidat (risi në fe).

﴿أَوْ يُصِيبَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ﴾

"... ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm."

Pra, dënim në këtë botë: me vrasje, dënim të paracaktuar fetarisht, burgosje e të ngjashme, siç ka transmetuar imam Ahmedi: "Na ka treguar Abdurrazaku, na ka treguar Mameri, nga Hemam ibn Munebihu, i cili ka thënë: "Kështu na ka thënë

Ebu Hurejra, i cili ka thënë: "I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë:¹

«مَثَلِي وَمَثَلُكُمْ كَمَثَلِ رَجُلٍ اسْتَوْقَدَ نَارًا فَلَمَّا أَضَاءَتْ مَا حَوْلَهَا جَعَلَ الْفَرَاشُ وَهَذِهِ الدَّوَابُّ اللَّاتِي يَقَعْنَ فِي النَّارِ يَقَعْنَ فِيهَا وَجَعَلَ يَحْجِرُهُنَّ وَيَغْلِبُهُنَّ فَيَقْتَحِمْنَ فِيهَا قَالَ فَذَلِكَ مَثَلِي وَمَثَلُكُمْ أَنَا أَخَذُ بِحَجْرِكُمْ عَنِ النَّارِ هَلُمَّ عَنِ النَّارِ فَتَغْلِبُونِي وَتَقْتَحِمُونَ فِيهَا»

“Unë, në raport me njerëzit, i shëmbëllej një njeriu që ndez një zjarr dhe, pasi ta ndriçojë vendin përreth, fluturat dhe insektet ia mësyjnë zjarrit dhe bien në të. Ai mundohet t'i mbrojë, porse ato e mundin dhe vërsulen drejt zjarrit. Kështu, unë ju kap për brezi që të mos bini në Zjarr, kurse ju, megjithatë, vërsuleni drejt tij.”

E shënojnë Buhariu dhe Muslimi nga hadithi i Abdurrezakut.

Sujutiu (Allahu e pastë mëshiruar!) në shkresën e tij, të quajtur: "Miftahul xhenneti fil ihtixhaxhi bis sunneti", ka thënë: "Dijeni (Allahu ju mëshiroftë!) se kushdo që mohon faktin se hadithi i Profetit ﷺ, qoftë fjalë, qoftë vepër, është argument, me kushtet e njohura në bazat (e fesë), bën kufër (mosbesim) dhe del nga rrethi i Islamit, si dhe do të ringjallet me hebrenjtë e të krishterët, ose me kë të dojë Allahu nga sektet jobesimtare."

Mbaroi qëllimi i fjalës së tij.

¹ Këto dënime implementohen në vendet ku zbatohet ligji islam. Shënim i përkthyesit.

Ekzistojnë shumë ethere (transmetime) nga sahabët, tabiinët dhe ata që erdhën pas tyre nga dijetarët, që tregojnë madhërimin, respektimin e Sunetit, domosdoshmërinë për të vepruar sipas tij dhe tërheqjen e vërejtjes nga kundërshtimi i tij. Shpresoj që ajetet, hadithet dhe etheret (transmetimet nga gjeneratat e para) që përmendëm të jenë të mjaftueshme dhe bindëse për kërkuesin e së vërtetës. E lusim Allahun që neve dhe të gjithë muslimanëve të na japë sukses drejt asaj që Ai është i kënaqur, të na shpëtojë nga shkaqet e zemërimit të Tij dhe të na udhëzojë të gjithë në rrugën e Tij të drejtë, sepse Ai është Gjithëdhëgues dhe i Afërt.

Salavatet dhe selamet qofshin për robin dhe të Dërguarin e Tij, Profetin tonë, Muhamedin, familjen, shokët e tij dhe ata që i ndoqën ata në mirësi!

Abdulaziz ibn Abdullah ibn Bazi (Allahu e pastë mëshiruar!)

Përmbajtja

Obliqueshmëria e veprimit sipas Sunetit të Profetit ﷺ dhe mosbesimi i atij që e refuzon atë (Pozita e Sunetit në Islam).	2
Autor:.....	2
Parathënie	2
Bazat që merren në konsideratë për vërtetimin e vendimeve fetare.....	3
Baza e parë: Kurani i madhërishëm.....	3
Baza e dytë: ajo që është saktësuar nga Dërguari i Allahut ﷺ, sahabët dhe ata pas tyre, nga njerëzit e dijes dhe të besimit.	6